



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rruga: "Abdi Toptani", ish-hotel Drini, Tiranë

Tel: 04 2268141; 04 2268142

Nr. 530 Prot.

Tiranë, më 16.05.2017

V E N D I M

Nr.121, datë.16.05.2017

Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.59, datë 17.06.2015 "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në instotucionin e Këshillit të Qarkut Korçë

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenit 34 e vijues të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 59, datë 17.06.2015, të Komisionerit,

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 59, datë 17.06.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në instotucionin e Këshillit të Qarkut Korçë".
2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

1. Ilir Osmanliu	Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
2. Joni Marko	Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
3. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt, në datën **29.05.2017**.

4. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Aktet e konstatimit, procesverbalet e mbajtura në subjekt si dhe dokumentacioni i administruar, lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionerit dhe verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve të kryera nga institucioni, do t'i paraqiten për të vijuar procesin respektivisht Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, brenda datës **30.05.2017**. Relacionet përkatëse duhet të përpilohen deri në datën **09.06.2017**. Më pas do t'i paraqiten për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohen vendimet për përmbylljen e proceseve, brenda datës **14.06.2017**.
5. Vendimi përfundimtar dhe vendimi paralajmërues i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e procedimit administrativ (*verifikimit*) do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur Këshilli i Qarkut Korçë.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrin masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA